


#INNO4EDU

Titulli i aktivitetit	
Pajisje për ngrënie	
Mosha	
Periudha zhvillimore (nga 3 deri në 8 vjet)	
Vendi / lokacioni	Vlera e karakterit
Kushte shtëpie	Vetëbesim
Koha e nevojshme për përgatitje	Koha e nevojshme për realizim
20 minuta	20-25 minuta
Qëllimet	
Qëllimi është që tek fëmija të zhvillohet shprehi për sjellje të shëndetshme, të sigurt dhe të kulturuar dhe të aftësohen për pjesëmarrje në aktivitetet e përditshme praktike jetësore në shtëpi.	
Rezultate të pritshme	
Kahje	
<u>Përgatitje paraprake për aktivitet</u> Përgatitje e materialeve për lojë, gjegjësisht pajisje për ngrënie. Përgatitje e skemave të ndryshme për vendosjen e pajisjeve.	
<u>Instrukcione / kahje për lojën</u> Në këtë lojë është e nevojshme të vizatohen skema të ndryshme, gjegjësisht ku janë vendosur pajisjet për ngrënie (p.sh. nga ana e majtë piruni, pjata, nga ana e djathtë thika, luga, ndër to facoleta, sipër tyre në të djathtë gota dhe kombinime të ndryshme syresh.	
<u>Aktivitet / lojë</u> Fëmijës i prezantohen pajisjet për ngrënie dhe i shpjegohet se si duhet drejt t'u qaset dhe	



t'i përdor. Bisedohet për sjelljen e kulturuar gjatë të ngrënies dhe respektim të njerëzve të tjerë teksa hanë. Po ashtu bisedohet për bontonin në restorante, veçanërisht bonton ndaj njerëzve që na shërbejnë.

Fëmijës i jepen kombinime të ndryshme (sipas vizatimeve paraprakisht të punuara), se si duhet t'i vendosë pajisjet në mënyrë identike. Pasi t'i bëjë të gjitha kombinimet, duhet ta gjejë kombinimin që e pasqyron pozitën e drejtë të pajisjeve për ngrënie. Pasi të ketë përfunduar loja e gjithë familja së bashku duhet të bëjë përgatitjen e një ushqimi dhe ta shtrojë tryezën sipas bontonit.

Shtojca	Materiale
<p data-bbox="198 577 365 611"><u>Shtojca nr. 1</u></p> 	<p data-bbox="873 640 1380 718">Pajisje për ngrënie (lugë, pirunë, thika, pjatë, gota, facoleta)</p>
Aktiviteti është përgatitur nga edukatorët:	
SKrijuar nga: Sonja Çallovaska, Vesna Peceva	
Dizajni grafik: Katerina Nikolovska	

